



## Kërkesë për Certifikatë të Rezidencës Tatimore në Republikën e Kosovës

*Për personin fizik afarist/juridik*

Ju lutem ofroni përgjigjet e plota në mënyrë që ATK-ja të mund të verifikojë gjendjen e biznesit tuaj, përndryshe kërkesa juaj mund të refuzohet.

Të dhënat për biznese:

1. Emri i biznesit:

2. Numri fiskal/numri unik i regjistrimit të biznesit:

3. Numri kontaktues dhe e - mail:

4. Adresa e biznesit:

5. Arsyeja pse kërkohet Certifikata e Rezidencës:

6. Periudha për të cilën kërkohet Certifikata e Rezidencës dhe shteti

7. Shënoni llojin dhe shumën e të ardhurave të huaja që pranohen gjatë periudhës për të cilën kërkohet Certifikata e Rezidencës:

8. Për të ardhurat nga jashtë, a aplikohen dispozitat që i nënshtrohen tatimit sipas METD për vendin përkatës? (nëse nuk paguhen të ardhurat nga jashtë, cilat janë arsyet që kërkoni CR-në?)

9. Të ardhurat që ju paguhen a janë për ju si individ, si një partner në ortakëri apo për një kompani me përgjegjësi të kufizuar? Ju lutem shënoni llojin dhe shumën e të ardhurave që paguhen

10. A jeni ju pronari përfitues i këtyre të ardhurave nga jashtë?  PO  JO

Nëse përgjigja është PO, duhet të jenë të plotësuar kriteret e mëposhtme. Ju lutem të nënshkruani deklaratën në vijim për pronarin përfitues.

Deklarata e pronarit përfitues

Unë deklaroj se:

- Jam pronari përfitues i të ardhurave për të cilat kërkohet zbatimi i marrëveshjes;
- Për qëllime të marrëveshjes së lartë cekur, përfituesi është rezident në:
- Unë nuk kam ndonjë njësi të përhershme në Kosovë, për të cilën këto të ardhura atribuohen;
- Këto të ardhura janë deklaruar ose do të deklarohen në autoritetin tatimor të shtetit ku jam rezident;

Data dhe Vendi

Nënshkrimi i përfituesit ose përfaqësuesit të tij/saj

Dokumentet tjera të nevojshme për Biznese që duhet t'i bashkëngjiten kësaj kërkesë janë:

- Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (e kompletuar);
- Certifikata e Numrit Fiskal/Numrit Unik të Regjistrimit të Biznesit;;
- Fatura e fundit e transaksionit me kompaninë për të cilën kërkohet CR (për atë periudhë);
- Kontrata për realizimin e aktivitetit.

## **Udhëzime rreth plotësimit të kërkesës për Certifikatë të Rezidencës nga personi fizik afarist/juridik**

**Kutia [1]** Shëno saktë emërtimin e biznesit në përputhje me të dhënat në ATK

**Kutia [2]** Shëno numrin fiskal të biznesit apo numrin unik të regjistrimit të biznesit.

**Kutia [3]** Shëno adresën e plotë të biznesit, në përputhje me të dhënat në ATK p.sh. “Rruga e Barrikadave” Nr.87, Prishtinë.

**Kutia [4]** Shëno arsyen pse kërkohet Certifikata e Rezidencës p.sh. për zbatimin e Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

**Kutia [5]** Shëno arsyen pse kërkohet Certifikata e Rezidencës p.sh. për zbatimin e Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

**Kutia [6]** Shëno periudhën për të cilën kërkohet Certifikata e Rezidencës dhe për cilin shtet kërkohet p.sh. Certifikata e Rezidencës kërkohet për vitin 2017 për Republikën e Shqipërisë.

**Kutia [7]** Shëno llojin dhe shumën e saktë të ardhurave që pranohen nga juridiksioni tjetër jashtë Kosovës gjatë periudhës për të cilën kërkohet Certifikata e Rezidencës p.sh. të ardhurat nga interesi në shumën prej 400€ për vitin 2017.

**Kutia [8]** Shëno nëse të ardhurat që janë gjeneruar në juridiksionin tjetër janë tatuar në atë juridiksion bazuar në Marrëveshjen për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë, p.sh. të ardhurat nga interesi të gjeneruara në Shqipëri janë tatuar në shumën prej 100 euro sipas Nenit 11 Interesi.

**Kutia [9]** Shëno llojin dhe shumën e të ardhurave që pranoni si individ, partner në ortakëri ose për një kompani me përgjegjësi të kufizuar në formë deklarative, p.sh. unë kam pranuar të ardhura, dividendë, në shumën prej 100 euro si aksionar i kompanisë XZ, Sh.P.K.

**Kutia [10]** Shëno PO nëse jeni pronar përfitues i të ardhurave të gjeneruara në juridiksionin tjetër dhe JO nëse nuk jeni pronar përfitues. *Sqarim! Pronari përfitues është personi fizik apo entiteti juridik i cili gëzon përfitimet nga një aset që ka në pronësi.*

**Vërejtje!** Kjo kërkesë është për biznese të cilave ju duhet Certifikata e Rezidencës së Kosovës për lehtësim ndërshtetëror nga Marrëveshja për Eliminim të Tatimit të Dyfishtë dhe dëshmi të rezidencës për qëllime tatimore.

Kërkesa për Certifikatë të Rezidencës duhet të plotësohet me të dhënat sipas kërkesës dhe t'i bashkangjiten dokumentet e kërkuara. Certifikata e Rezidencës mund të përdoret vetëm një herë për një kërkesë, në rast se ju duhet tjetër Certifikatë e Rezidencës duhet të aplikoni njëjtë përsëri me të gjitha të dhënat e kërkuara. Certifikata është valide për një (1) vit fiskal.

Ky formular pasi të plotësohet duhet të dorëzohet në ZQ të ATK fizikisht apo në mënyrë elektronike në email adresën [metd@atk-ks.org](mailto:metd@atk-ks.org), ndërsa për detaje apo informata shtesë mund të kontaktoni në tel: 0380/200-250-05